



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

Në mbështetje të nenit 8, 39,40 dhe 41 të Rregullores (ZKA) Nr.03/2020 për Marrëdhënie Pune në Zyrën Kombëtare të Auditimit, me datën 30 mars 2021, shpallet ky:

## KONKURS I BRENDSHËM – RISHPALLJE

### I. Për plotësimin e vendeve të lira të punës përmes procedurave të promovimit në detyrë:

1. Specialist për metodologji për auditimin financiar dhe të pajtueshmërisë – një (1) vend pune. Numri i referencës: SM/ZKA/05-02/21;
2. Specialist për sigurimin e cilësisë për auditimin financiar dhe të pajtueshmërisë – dy (2) vende pune; Numri i referencës: SSC/ZKA/06-02/21.

### II. Detyrat dhe përgjegjësitë themelore

Detyrat dhe përgjegjësitë themelore për secilin vend të vend të punës janë të përcaktuara me aktet përkatëse dhe në përputhje me Rregulloren (ZKA) Nr. 02/2020 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Zyrën Kombëtare të Auditimit dhe përshkrimin e detyrave të punës.

### III. Kualifikimet e kërkuara:

#### 1. Për pozitën e punës Specialist për metodologji për auditimin financiar dhe të pajtueshmërisë, kërkohen:

- 1.1. Diplomë fakulteti;
- 1.2. Shtatë (7) vite përvojë pune profesionale në auditim;
- 1.3. Të jetë i çertifikuar për auditim të jashtëm ( çertifikim për auditor apo auditor i certifikuar i sektorit publik).
- 1.4. Për kualifikimet themelore për këtë vend pune në auditimet e performancës dhe auditimet e teknologjisë informative kërkohen kualifikimet sipas paragrafit 2 dhe 3 të nenit 29 të Rregullores (ZKA) Nr.02/2020 për Organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës.

#### 2. Për pozitën e punës Specialist për sigurimin e cilësisë për auditimin financiar dhe të pajtueshmërisë, kërkohen:

- 2.1. Diplomë fakulteti;
- 2.2. Shtatë (7) vite përvojë pune profesionale në auditim;
- 2.3. Të jetë i çertifikuar për auditim të jashtëm (çertifikim për auditor apo auditor i certifikuar i sektorit publik).

#### **IV. Kriteret për promovim në detyrë**

Përveç kualifikimeve profesionale, për promovimin në detyrë aplikohen edhe kriteret e përcaktuara me nenin 40 si dhe zhvillohet intervistimi i kandidatëve sipas nenit 41 të Rregullores (ZKA) Nr.03/2020 për Marrëdhënie Pune në Zyrën Kombëtare të Auditimit.

#### **V. Kohëzgjatja e emërimit**

Për të gjitha pozitat e punës, kandidatët e promovuar, emërohen për afat të pacaktuar. Ushtrimi efektiv i detyrave nga kandidatët e emëruar bëhet për zbatimin e planit të auditimit 2021/22.

#### **VI. Shkathtësit e kërkuara**

Kandidatët duhet të kenë shkathtësitë përkatëse për pozitat e caktuara, përkatësisht sipas atyre që janë përcaktuar me aktin për përshkrimin e detyrave për vendet përkatëse të punës.

#### **Procedura e Konkurrimit:**

Formularin e konkurrimit kandidatët mund ta marrin në recepcionin e objektit të Zyrës Kombëtare të Auditimit ose mund të tërhiqen nga faqja e internetit e ZKA-së në adresën [www.zka-rks.org](http://www.zka-rks.org) dhe dorëzohen në Divizionin e Burimeve Njerëzore në adresën: Lagja: Arbëria, rr. "Ahmet Krasniqi" nr. 210 – Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00, formulari konkurrues dhe dokumentet mbështetëse mund të dorëzohen edhe përmes adresës elektronike në adresën [rekrutimi@oagks.org](mailto:rekrutimi@oagks.org) ose përmes postës. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr.tel. 038/606-004, ext:1005;

#### **Kandidatët duhet t'i dorëzojnë dokumentet e nevojshme:**

- Formularin zyrtar të ZKA-së për konkurrim.

Dokumentet si më poshtë, nëse janë pjesë e dosjes personale, nuk dorëzohen me formularin për konkurrim, përveç dokumenteve të tjera shtesë të cilat mund t'i dorëzoni bashkë me formularin për konkurrim.

- Kopjen e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- Kopjet e diplomave për kualifikimet shkollore. Diplomat e fituara jashtë Kosovës duhet të jenë të nostrifikuara;
- Kopjet e kualifikimeve të tjera profesionale që lidhen me pozitën e punës;
- Dëshmitë për përvojën e punës të lëshuara nga organizata përkatëse – punëdhënësi;

Vetëm formulari zyrtar i konkurrimit do të merret parasysh. Formularët e konkurrimit të dorëzuar pas afatit të paraparë nuk shqyrtohen.

Kandidatët e të cilët i plotësojnë kushtet e kërkuara do të informohen, gjithashtu kandidatët e të cilët nuk i plotësojnë kushtet do të njoftohen se nuk janë përzgjedhur t'i nënshtrohen procedurës për plotësimin e vendeve të lira të punës.

Konkursi është i hapur 5 ditë pas ditës së publikimit në faqen elektronike zyrtare të ZKA-së dhe në tabelen e shpalljeve zyrtare, duke filluar nga data 30.03.2021, kurse afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit është data 06.04.2021, ora 16.00.

#### **Shënim:**

Në përputhje me nenin 39 paragrafi 3 të Rregullores (ZKA) Nr.03/2020 për Marrëdhënie Pune në Zyrën Kombëtare të Auditimit, promovimet në detyrë efektivisht hyjnë në fuqi në fillim të sezonit të auditimit 2021/2022, përkatësisht nga data 1 shtator 2021.